



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve, 12.2 shkronja c) dhe 40.2 shkronja g), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neneve 2.1, 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 dhe neneve, 15.2 shkronja c) dhe 34.2 shkronja g), të Statutit të Komunës, nr.01-1/298-10, dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, si dhe në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Ministria e Financave (shkresa nr.02-3250-1 dt.18.10.2017) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (shkresa nr.43-1200/7 dt.23.10.2017), në procedur të rishqyrtimit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, miratoi këtë,

### RREGULLORE PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

#### I.

##### Dispozitat e përgjithshme

##### Qëllimi

##### Neni 1

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e taksave, tarifave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor, mënyra e caktimit dhe arkëtimit të tyre si dhe kriteret tjera për zbatimin e kësaj Rregulloreje në territorin e Komunës së Podujevës.

#### II.

##### Taksat, tarifat dhe gjobat komunale

##### Neni 2

- 1.Taksat administrative komunale,
- 2.Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare,
- 3.Taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe shërbime profesionale,
- 4.Taksat për leje për ndërtim dhe rrënim të ndërtesave dhe strukturave tjera,
- 5.Tarifat për shërbime publike,
- 6.Taksat në transaksion të pasurisë së paluajtshme,
- 7.Taksat për regjistrimin vjetor të automjeteve motorike,
- 8.Tarifat për shërbime dhe produkte kadastrale,
- 9.Taksat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- 10.Bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore
- 11.Tarifat dhe taksat administrative në lëmin e arsimit

- 12.Taksa dhe tarifa tjera komunale
- 13.Gjobat nga trafiku
- 14.Gjoba për ndërhyrje pa leje në infrastrukturë publike dhe
- 15.Gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale
- 16.Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen do të caktohen sipas Drejtive përkatëse.

### **Neni 3**

- 1.Obligues të taksave dhe tarifave komunale sipas kësaj Rregulloreje janë personat juridik dhe personat fizik.
- 2.Obligimi për pagesën e taksës dhe tarifës komunale fillon në momentin e shfrytëzimit të së drejtës, sendeve dhe shërbimeve përkatëse.
- 3.Obligimi i taksës komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe për shërbime profesionale fillon prej datës së regjistrimit të subjektit në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës,
- 4.Taksa komunale vjetore, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, caktohet në shumën vjetore, ndërsa paguhet në dy këste të barabarta: kësti i parë deri më 30 qershor, dërsa kësti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit për të cilin caktohet taksa vjetore komunale.

### **Neni 4**

#### **Taksat administrative komunale**

- 1.Parashtesa, kërkesa, informata dhe shkresa tjera në interes të përgjithshëm nga: Kryetarët e lagjeve të qytetit dhe komiteteve të fshatrave si dhe peticionet nga grupet e qytetarëve.....pa pagesë
  - 1.1.Kërkesa për aplikim për punësim.....pa pagesë
  - 1.2.Kërkesa për aplikim për bursa të studentëve dhe nxënësve.....pa pagesë
  - 1.3.Kërkesa për pagesën e faturave të operatorëve të ndryshëm për punët dhe shërbimet e kryera sipas kontratës.....pa pagesë
  - 1.4.Kërkesa për të cilën nuk zhvillohet procedurë administrative.....1.00 €
  - 1.5.Kërkesa për të cilën zhvillohet procedurë administrative.....2.00 €
  - 1.6. Ankesa.....pa pagesë
  - 1.7.Vërtetimi për mbajtjen prindit-prindërve.....3.00 €
  - 1.8.Vërtetimi që personi ka jetuar në një bashkësi familjare me anëtarin e familjes deri në momentin e vdekjes së tij.....2.00 €
  - 1.9.Vërtetimi për qëndrim të përkohshëm të shtetasve të huaj.....3.00 €
  - 1.10.Vërtetim që personi është i zhdukur.....pa pagesë
  - 1.11.Kërkesa të tjera .....1.00 €
  - 1.12.Kërkesa për qasje në dokumentet publike.....pa pagesë, ndërsa tarifat për shpenzimet e përgatitjes dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve publike aplikohen sipas Rregullores nr.02/2012/MF për tarifat në qasje në dokumente publike.
- 2.Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nga Ofiqaria
  - 2.1.Certifikata, Ekstrakti i e lindjes.....1.00 €
  - 2.2.Certifikata e martesës (certifikata e rregullt martesore).....1.00 €
  - 2.3.Certifikata e vdekjes.....1.00 €

2.4.Certifikata mbi statusin martesor (beqar, i shkurorëzuar, i/e ve).....	1.00 €
2.5.Certifikata që personi është në jetë.....	1.00 €
2.6.Certifikata për bashkësinë familjare.....	2.00 €
2.7.Certifikata për lidhje martese (aftësia martesore-kapaciteti martesor me shtetas të huaj) .....	5.00 €
2.8.Certrifikata e shtetësisë.....	1.00 €
2.9.Certifikata e vendbanimit.....	1.00 €
2.10.Certifikata për lajmërim – ç’lajmërim të vendbanimit.....	2.00 €
2.11.Vërtetimi që personi nuk është i regjistruar në LAL.....	2.00 €
2.12.Deklarata me dy dëshmitarë (në lëmin e ofiqarisë).....	2.00 €
2.13.Regjistrimi i martesave në mes shtetasve të Kosovës (ceremonia e lidhjes së martesës - kurorëzimi) .....	8.00 €
2.14.Regjistrimi i martesave me shtetas të huaj.....	8.00 €
2.15.Lidhja e kurorëzimeve jashtë objektit zyrtar;	
2.15.1.Gjatë orarit të punës në territorin e Komunës.....	20.00 €
2.15.2.Gjatë orarit të punës jashtë territorit të Komunës.....	40.00 €
2.16.Lidhja e kurorëzimeve jashtë objektit zyrtar pas orarit të punës;	
2.16.1.Në territorin e Komunës.....	30.00 €
2.16.2.Jashtë territorit të Komunës.....	50.00 €
2.17.Vendimi për regjistrimin e mëvonshëm në LAL.....	2.00 €
2.18.Vendimi për ndërrimin e emrit apo mbiemrit.....	5.00 €
2.19.Korrigimet e emrit apo mbiemrit.....	2.00 €
2.20.Konfirmimet dhe vërtetimet tjera (lindja, martesa, vdëkja, statusi martesor, certifikata për lidhje martese etj.).....	2.00 €
2.21.Certifikata për afërsinë (lidhjen) familjare.....	1.00 €
2.22.Konfirmimet për dosjet e lëndëve.....	10.00 €
2.23.Vërtetimi për qëndrim të përkoshëm të shtetasve të huaj .....	2.00 €
2.24.Vërtetimet tjera.....	2.00 €
2.25.Taksat për shërbime në E – kiosk janë të njëjtë me taksat për dokumentet përkatëse.	

## Neni 5

### Lirim nga pagesa e taksës

- 1.Nga pagesa e taksës administrative komunale për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nga nenii 4, lironhen:
- 2.Shfrytëzuesit e skemave sociale dhe anëtarët e tyre të evidentuar në kartelë.
- 3.Familjarët e dëshmorëve të luftës, të viktimave të luftës të zhdukurve dhe të rënëve civil gjatë luftës (prindërit, bashkëshorti-ja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare), veteranët e luftës dhe të burgosurit politik,
- 4.Invalidët e luftës, invalidët e punës dhe personat me aftësi të kufizuara,
- 5.Organizatat jo qeveritare për interesa të përgjithshme dhe
- 6.Bashkësitë fetare.
- 7.Për lirim nga pagesa, palët duhet të paraqesin dëshmi me shkrim se e kanë statusin e njërsë prej kategorive të lartpërmendura.

**Neni 6**  
**Taksat komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe për shërbime profesionale**

**1. Kategoria A**

- 1.1.Bankat, ndërmarrjet publike, terminalat doganore, korporatat, kompanitë tjera, tregtia me shumicë e karburanteve dhe lubrifikantëve dhe tregtia me shumicë e produkteve farmaceutike.....250.00 €  
 1.2.Kompanitë e sigurimit të pasurisë, personave dhe automjeteve.....200.00 €

**2. Kategoria B**

- Subjektet afariste të ndërtimtarisë së lartë, (si ndërtimi i banesave kolektive, objekteve industriale, komerciale, arsimore e të ngjashme, përvèç atyre për banim individual me infrastrukturë përcjellëse, instalime ajrore në lëmin e energetikës dhe telekomunikacionit) dhe të ulët (punët e instalimeve nëntokësore të rrymës, ujit, kanalizimit, telekomunikacionit, asfaltimit të rrugëve dhe terreneve të ndryshme e të ngjashme.....150.00 €

**3. Kategoria C**

- Hotelet, minierat, gurëthyesit, tregtia me pakicë e karburanteve dhe lubrifikantëve në qytet dhe në magistralen Merdar-Prishtinë, bastoret sportive, fabrikat, repartet për prodhimin e materialit ndërtimor, ushqimor, pijeve dhe artikujve tjerë.....125.00 €

**4. Kategoria D**

- Motelet, siloset, mikrobankat, postat private, veprimtaritë për sigurimin fizik të objekteve dhe personave, transferi i parave, qendrat e kontrollimeve teknike të automjeteve, qendrat tregtare, transporti i jashtëm i mallrave dhe udhëtarëve, dhe agjencitë turistike.....100.00 €

**5. Kategoria E**

- Ordinancat shëndetësore private, avokaturat, noteritë, veprimtaritë e auditimit, ndërmarrjet projektuese, farmacitë me pakicë (barnatoret shëndetësore), veprimtaritë tjera profesionale, restorantet, ndërmarrjet dhe agjencitë e udhëtimit, transporti publik dhe privat i udhëtarëve dhe mallrave, grumbullimi dhe përpunimi i mbeturinave, shtypshkronjat, subjektet për ndërmjetësim në transaksionin e paluajtshmërive dhe tregjeve, shpërndarësit e rrjetit të internetit dhe televizionit kabllor, tregtia me pakicë e karburanteve dhe lubrifikantëve jashtë qytetit dhe jashtë rrugës magistrale Merdar-Prishtinë, mullinjtë dhe lotaritë, tregtia me shumicë e duhanit.....75.00 €

**6. Kategoria F**

- 6.1.Tregtia me pakicë e tekstitilit, trikotazhit, artikujve ushqimor dhe artikujve të tjerë, sipas sipërfaqes së lokalit afarisë, si vijon:

- |   |                                    |               |
|---|------------------------------------|---------------|
| 6.1.1.....                                | deri në 50 m <sup>2</sup> ,        | .....25.00 €  |
| 6.1.2.Prej.....51 m <sup>2</sup> .....    | deri në 100 m <sup>2</sup> .....   | .....37.00 €  |
| 6.1.3 Prej.....101 m <sup>2</sup> .....   | deri në 200 m <sup>2</sup> .....   | .....50.00 €  |
| 6.1.4.Prej.....201 m <sup>2</sup> .....   | deri në 500 m <sup>2</sup> .....   | .....125.00 € |
| 6.1.5.Prej.....501 m <sup>2</sup> .....   | deri në 1.000 m <sup>2</sup> ..... | .....250.00 € |
| 6.1.6.Prej.....1.001 m <sup>2</sup> ..... | deri në 1.500 m <sup>2</sup> ..... | .....375.00 € |
| 6.1.7.Prej.....1.501 m <sup>2</sup> ..... | deri në 2.000 m <sup>2</sup> ..... | .....500.00 € |
| 6.1.8.Mbi.....2.000 m <sup>2</sup> .....  |                                    | .....625.00 € |

## **7. Kategoria G**

Kontabilistët, rëntgeni dhe laboratorët privat medicinal, thertoret, barnatoret bujqësore, veprimtaritë e veterinarisë, tombolat, veprimtaritë e lojërave me automate, telekomunikimi, kafiteritë që shërbejnë me pije alkoolike, produksionet muzikore, depot e materialit ndërtimor, drunjëve, zallit, artikujve ushqimor, pijeve dhe artikujve, sallonet e mobileve, rëntgenët e përgjithshëm privat, pompat e gazit dhe kooperativat bujqësore,.....37.00 €

## **8. Kategoria H**

Pishinat, veprimtaritë rekreative sportive, auto-transportuesit, tregjet e shtazëve, emëve dhe perimeve, automjeteve dhe tregjeve tjera, fitnes klubet, fushat sportive rekreative, parkingjet private, furrat e bukës, pishinat.....30.00 €

## **9. Kategoria I**

Dyqanet e pavarura hoteliere (D.P.H-të), dyqanet e pavarura zejtare (D.P.Z-të), dyqanet e pavarura shërbyese (D.P.SH-të), stacionet eTV dhe radiot lokale, internetkafetë, videoklubet, veprimtaritë për aftësim profesional - (kurset), auto-serviset, serviset e TV aparateve, kompjuterëve dhe të amvisërisë, drithnikët, mini-fermat dhe autoshkollat .....25.00 €

## **10. Kategoria J**

Subjektet afariste që nuk janë përfshirë në kategoritë paraprake ngarkohen.....25.00 €

## **11. Kategoria K**

Kombi-taksitë, auto-taksitë, tregtia lëvizëse, tregtia në tezga, kioskat dhe auto-larjet.....12.00 €

12.Njësitë e subjekteve afariste ngarkohen me 30% nga ngarkesa bazë, me përjashtim të të para të subjekteve afariste nga kategoria A, të cilat pavarësisht emërtimit që kanë, paraqesin njësinë bazë.

13.Veprimtaritë e përmendura në Kategoritë B.C.D.E,F, G,H,I dhe J pavarësisht se ku e kanë selinë e tyre, konsiderohen njësi, për teritorin e komunës ku operojnë.

14.Subjektet e reja afariste lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin rexhistrohen dhe vitin vijuese.

15.Subjektet e reja afariste , pronar të të cilave janë femra, lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe dy vitet vijuese.

16.Subjektet e reja prodhuese dhe bujqësore,si dhe bizneset e reja me kapital nga diaspora lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe tri vitet vijuese.

17.Subjektet afariste që operojnë jashtë zonës së III-të sipas Planit Zhvillimor Komunal, ngarkohen në masën 70 % të taksës komunale.

18.Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e shuanë në gjashtëmujorin e parë të vitit nuk ngarkohen me taksën komunale për vitin përkatës, ndërsa subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e shuanë në gjashtëmujorin e dytë, ngarkohen me 50% të taksës bazë komunale për vitin përkatës.

19.Kërkesa për qertifikat si dëshmi për kryerjen e obligimeve.....1.00 €

20.Për kërkesat dhe shërbimet tjera aplikohen taksat sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje

21.Subjketet afariste që pretendojnë se nuk kanë ushtruar aktivitet afarist mund të parashtojnë kërkesë për shlyerjen e taksës komunale vjetore (borxhit). Shuma e taksës për kërkesë është.....10.00 € Kërkesa mund të bëhet për vitin ose vitet që pala pretendon se nuk ka ushtruar aktivitet afarist. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, me aktvendim të posaçëm mund t'ua shlyhej ngarkesat komunale vjetore për vitin ose vitet për të cilat, pala sjellë

formularin e deklarimit të tatimit me qarkullim 0 dhe pagesë 0, për vitin – vitet ose pasqyrën financiare nga Administrata Tatimore e Kosovës.

22. Subjekteve afariste, të cilat kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të fatkeqësive elementare ose për ndonjë shkak tjetër, në bazë të dëshmive të lëshuara nga organet kompetente, me kërkesën e yre, mund t'iu shlyhet ngarkesa vjetore e caktuar për vitin në të cilin kanë pësuar dëme.
23. Ankesa e ushtruar kundër aktvendimit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për caktimin e ngarkesës komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe profesionale nuk e shtyn ekzekutimin e tij, nëse nuk është paraparë ndryshe me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### Neni 7

1. Kriter për llogaritjen e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit është buxheti domosdoshëm i organeve kompetente komunale për të lëshuar leje ndërtimore, mbikqyrjen e ndërtimit dhe inspektimin e ndërtimit, i pjesëtar me numrin total të metrave katorr të lejuar me lejen ndërtimore.
2. Kriter për llogaritjen e tarifës për ndikim nga rritja e densitetit të infrastrukturës janë shpenzimet e buxhetit të Komunës së Podujevës në arsim, shëndetësi, shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim dhe kulturë, rini dhe sport.
3. Llogaritja e taksës bëhet në  $m^2$  bruto të objektit për të cilin është dhënë pëlqimi në dokumentacionin teknik-projektin kryesor në bazë të të cililit lejohet ndërtimi.
4. Bazë për llogaritjen e taksës për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, është projekti kryesor për të cilin lejohet ndërtimi.
5. Taksa administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit.....2.71 e/ $m^2$
6. Tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.....100.28 € për kokë banori
7. Me rastin e dorëzimit të aplikacionit për leje të ndërtimit paguhet taksa administrative fiksë në shumën.....50.00 €  
Për aplikuesit të cilëve u aprovohet aplikacioni për leje ndërtimi, taksa fiksë administrative u llogaritet si pjesë e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, Ndërsa aplikuesve të cilëve u refuzohet aplikacioni, kjo taksë nuk kthehet për shkak të shpenzimeve për shqyrtimin e aplikacionit.
8. Për objektet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi e as dokumentacion teknik, por vendosja e tyre bëhet vetëm me kushte të ndërtimit apo pëlqim përkatës, paguhet taksa administrative dhe densitetit në infrastrukturë në shumën fiksë.....100.00 €
9. Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej.....0.2% të vlerës investuese të projektit.

### Neni 8

#### Benefitet nga taksa për rregullimin e tokës ndërtimore

1. Nuk është obligues i taksës për rregullimin e tokës ndërtimore investitor, nëse:
- 1.1. Ndërton objekt të karakterit social, shëndetësor, arsimor dhe fetar (jofitimprurës),
  - 1.2. Nërton objekte në pronësi shtetërore për me interes të përgjithshëm,
  - 1.3. Ndërton objekte për destinime humanitare,
  - 1.4. Ndërton objektin investiv në pronësi komunale me mjete financiare si donacion nga organizatat - shoqatat humanitare,
  - 1.5. Ndërton objekt investiv në fshatrat që kufizohen me zonat kufitare, destinimi i të cilave është banimi individual dhe objekte që kanë për qëllim zhvillimin e bujqësisë.

- 1.6.Ndërton objekte të destinuara për lëmin arsimor, kulturor, sportiv, shëndetësor, si dhe qendra rekreative që ndërtohen me mjete buxhetore me investim të komunitetit apo me donacione, dhe që janë të interesit të përgjithshëm.
- 1.7.Ndërton objekt individual banimi për zgjidhjen e çështjes së banimit të familjes së ngushtë të dëshmorit të luftës, invalidit të luftës dhe punës me shkallë të invaliditetit prej 50% e më shumë, viktimsë civile të luftës (prindërit, bashkëshorti-ja, bijtë dhe bijat) dhe të personave me aftësi të kufizuara si dhe nëse për ushtrimin e veprimtarisë individuale ndërton objekt asarist në sipërfaqe deri në 120 m<sup>2</sup>
- 1.8.Në rast të tjetërsimit të objektit nga paragrafi paraprak, përfituesi i kësaj të drejtë është obliguar që paraprakisht të paguaj taksën për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e objektit të banimit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
- 1.9.Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit është e obliguar që ndalesën nga paragrafi paraprak ta evidentoj në aktvendimin për Lejen ndërtimore si dhe një kopje të aktvendimit së pari t'ia dërgoi Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e cila është e obliguar që lidhur me këtë të mbajë evidencë dhe në rast të tjetërsimit të këtyre objekteve të cakttoi dhe inkaso takson në transaksion të pronës.
- 1.10.Rindërton objektin në themel e objektit i cili është dëmtuar nga lufta apo fatkeqësitë tjera elementare sipas kategorisë IV dhe V të shkallës së dëmtimit.  
Për lirim nga pagesa palët duhet të paraqesin dëshmi me shkrim se e kanë statusin njërs prej kategorive të lartpërmendura.
- 2.Në rastet kur kemi të bëjmë me ndërtimin e objekteve që nuk janë cekur më lartë, si psh. qendër rekreative apo ent shëndetësor, atëherë duhet të merret leje e veçantë nga Organi kompetent për lirim nga pagesa.

#### **Neni 9 Lartësia e taksës së paraparë ndërtimore me këtë Rregullore zvogëlohet**

- 50% për ndërtimin e objekteve investive ekzistuese që posedojnë leje ndërtimi dhe dokumentacionin tjetër teknik.

#### **Neni 10 Tarifa për shërbime publike**

- 1.Lejet për ndërhyrje në infrastrukturë dhe hapësirë tjetër publike:
 

1.1.Prerja e asfaltit në rruge dhe trotuare 1m <sup>2</sup> .....	70.00 €
1.2.Prerja e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve etj. 1m <sup>2</sup> .....	30.00 €
1.3.Shfrytëzuesi i lejes për ndërhyrje, pas ekzekutimit të punëve është i obliguar që kanalin e hapur ta mbulojë me zhavorr, sipas standardeve dhe me mbikqyrje nga inspektori i ndërtimit, kurse asfaltimin e bën Komuna.	
- 2.Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike; vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla lëvizëse, të përkohshme -- sezionale në të cilat kryhet veprimtaria tregtare, hoteliere si dhe vendosja e pajisjeve të caktuara teknike, tarifa mujore për m<sup>2</sup>:
 

Zona I .....	10.00 €
Zona II .....	8.00 €
Zona III .....	6.00 €

3.Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e gjeneratorëve statik, tarifa mujore për m<sup>2</sup>:

Zona I .....	20.00 €
Zona II .....	15.00 €
Zona III .....	10.00 €

4.Shfrytëzime tjera të hapësirës publike – ekspozimi dhe deponimi i mallit, ambalazhit, tarifa mujore për m<sup>2</sup> :

Zona I .....	20.00 €
Zona II .....	15.00 €
Zona III .....	10.00 €
Jashtë Zonës së tretë.....	5.00 €

5.Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e mjeteve për akullore dhe mjeteve tjera të ngjashme – tarifa mujore:

Zona I për aparat.....	15.00 €
Zona II për aparat.....	10.00 €
Zona III për aparat.....	7.00 €

6.Shfrytëzimi i hapësirës publike para objektit hotelier, tarifa mujore për m<sup>2</sup>:

Zona I .....	3.00 €
Zona II .....	2.00 €
Zona III .....	1.00 €

7.Shfrytëzimi i hapësirës publike për destinime tjera:

7.1.Për shfrytëzimin e përkohshme të tokës për vendosjen e cirqeve, kolovajzave, autodromeve dhe poligoneve për aftësimin e vozitësve të mjeteve motorike, taksa ditore për m<sup>2</sup>..... 0.02 €

7.2.Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e automjetit lëvizës, për shitjen e ushqimit të shpejtë gjatë manifestimeve dhe tubimeve të ndryshme, taksa mujore.....40.00 €

7.3.Automjetet lëvizëse nga pika paraprake nuk kanë të drejtë të vendosen në një vend në mënyrë te përhershme (statike).

7.4.Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura hapura lëvizëse me mekanizëm, taksa vjetore për tendë për m<sup>2</sup>.....4.00 €

7.5.Shtrirja e rrjetit kabllor të internetit për metër gjatësi .....0.50 €

7.6.Vendosja e antenave (pjatave satelitore) për përcjellje të programeve satelitore televizive, taksa vjetore për copë.....10.00 €

7.7.Për vendosjen e shkallëve para objektit në të cilin ushtrohet veprimtaria e rexhistruar, tarifa vjetore.....100.00 €

7.8.Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24orë.....25.00 €

7.9.Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në trotuar për 1 muaj.....15.00 €

7.10.Vërtetimi i rendit të udhëtimit, për operatorin transportues paguhet ne shumën vjetore për një vit për 1 km.....0.50 €

7.11.Leja për një hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 ton për 24 orë.....25.00 €

7.12.Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar.....30.00 €

7.13.Vendosja e foltoreve telefonike – taksa mujore.....10.00 €

7.14.Dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për kyçje – qasje ne infrastrukturën rrugore dhe pëlgjime tjera.....10.00 €

8.Për ekspozimin e pllakateve (panove) reklamuese, tarifa vjetore për m<sup>2</sup>:

8.1.Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet, taksa vjetore për m<sup>2</sup>.....35.00 €

8.2.Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve me ndriçim në qytet, taksa Vjetore për m <sup>2</sup> .....	45.00 €
8.3.Ekspozimi i panove reklamuese jashtë qytetit, taksa vjetore për m <sup>2</sup> .....	20.00 €
8.4.Ekspozimi i panove reklamuese me ndriçim, jashtë qytetit, taksa vjetore për m <sup>2</sup> .....	30.00 €
8.5.Vendosja e reklamave elektronike – ekraneve, taksa vjetore për m <sup>2</sup> .....	80.00 €
8.6.Ekspozimi i reklamave në automjete, autobus për m <sup>2</sup> .....	20.00 €
8.7.Ekspozimi i reklamave në automjete, mbi 8+1 ulëse, për m <sup>2</sup> .....	15.00 €
8.8.Ekspozimi i reklamave në automjete, automjete 4+1 ulëse, për m <sup>2</sup> .....	10.00 €
8.9.Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike – ekspozimi (reklamimi) taksa mujore për m <sup>2</sup> .....	10.00 €
8.10.Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm	
8.11.Nëse pllakati është i vendosur në pronë private, por për qëllim ka reklamimin, pala paguan sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, me zbritje.....	50%
8.12.Nëse reklamimi bëhet më pak se 30 ditë shtohet vlera për.....	100%
8.13.Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar.	
8.14.Pagesa e tarifave për shërbimet e parapara me këtë nen bëhet me rastin e marrjes së lejes përkatëse.	
9.Për shfrytëzimin e hapësirës publike për lojëra të fatit, argëtuese, dhe për vendsojen e argëtuese, taksat mujore paguhet si vijon:	
9.1.Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e aparateve për lojëra te fatit, lojëra argëtuese etj. taksa mujore për çdo aparat sipas llojit.....	10.00 €
9.2.Për shfrytëzimi e hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese), taksa mujore për m <sup>2</sup> .....	1.50 €
10.Në procesin për plotësimin e kushteve teknike për auto-taxi, traktor, automjete transportuese dhe traktor, taksa vjetore si vijon :	
10.1.Për 5 ulëse.....	10.00 €
10.2.Për 9 ulëse – minibusët.....	15.00 €
10.3.Për kamionët e lehte deri 3.5 T, traktorët.....	20.00 €
10.4.Për kamion, autobus dhe mjete tjera të rënda.....	30.00 €
11.Rezervimi i parkingjeve komunale dhe publike, paguhet taksa mujore:	
11.1.Në parkingjet e Komunës.....	20.00 €
11.2.Në parkingjet publike ne shirita të ndara të rrugëve – trotuareve:	
11.2.1.Personi fizik.....	15.00 €
11.2.2.Personi juridik.....	25.00 €
12.Taksa ditore në parkingjet komunale dhe publike, paguhet si vijon:	
12.1.Në parkingjet e Komunës.....	1.00 €
12.2.Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I.....	1.00 €
12.3.Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II.....	0.50 €
13.Licencimi:	
13.1.Licencimi i kompanive të Autobusve.....	120.00 €
13.2.Licencimi –Leja e punës për operator Radio Taxi.....	80.00 €
13.3.Leje e punës për Auto Taxi.....	25.00 €
13.4.Leje e punës për automjete transportuese të mallrave deri në 12 t. ....	80.00 €
13.5.Ndrrimi i lejejs së punës -- dokumentit para skadimit të afatit.....	10.00 €
14.Pëlqimi i mbrojtjes nga zjarri	
14.1.Për tu pajisur me pëlqimin e mbrojtjes nga zjarri, aplikuesi duhet të paguaj.....	20.00 €

15.Nga pagesa e tarifave sipas këtij neni lirohen:

- 15.1.Iniciativat qytetare-kërkjesat për projekte të infrastrukturës publike,
- 15.2.Kompanitë publike, me rastin e kërkimit të lejes për ndërhyrje në infrastrukturë, për mirëmbajtje të rrjeteve të tyre (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik,etj.)
- 15.3.Organizatat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare.
- 15.4.Nga pagesat e tarifave nga neni 10.1 lirohen kompanitë Publike të cilat pas punëve të riparimit dhe instalimit do të pranonin t'i rikthenin vend-punishtet në gjendjen e tyre fillestare – në afat prej 15 ditësh, me garanci për një vit. Kjo i i përfshin të gjitha sipërfaqet (rrugë, trotuare, sipërfaqet e gjelbëruara dhe hapësirat tjera të dëmtuara).
- 15.5.Nga pagesa e tarifës nga neni 10.8 pika 9 lirohen organizatat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare.
- 15.6.Për lirim nga tarifat sipas nenit 10.15, nënparag.1,2,3,4,dhe 5, të kësaj Rregulloreje kërkuesi i shërbimit duhet të ofrojë dëshmi përkatëse.

16.Shfrytëzimi i hapësirave publike të përkohshme (ditore) në lokacionin e tregut.... 1ditë x 1.50 €/m<sup>2</sup>

- 16.1.Automjetet lëvizëse nga pika paraprake nuk kanë të drejtë të vendosen në një vend në mënyrë të përhershme (statike).
- 16.2.Për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm, taksa vjetore për tendë për m<sup>2</sup>.....4.00 €
- 16.3.Shtrirja e rrjetit kabllor të internetit për metër gjatësi .....0.50 €
- 16.4.Vendosja e antenave (pjatave satelitore) për përcjellje të programeve satelitore televizive, taksa vjetore për copë.....10.00 €
- 16.5.Për vendosjen e shkallëve para objektit në të cilin ushtrohet veprimitaria e regjistruar, tarifa vjetore.....100.00 €
- 16.6.Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24 orë.....25.00 €
- 16.7.Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në trctuar për 1 muaj.....15.00 €
- 16.8.Vërtetimi i rendit të udhëtimit, për operatorin transportues paguhet ne shumën vjetore për një vit për 1km.....0.50 €
- 16.9.Leja për një hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 ton për 24 orë.....25.00 €
- 16.10.Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar.....30.00 €
- 16.11.Vendosja e foltoreve telefonike – taksa mujore.....10.00 €

## Neni 11 Taksat komunale vjetore për regjistrimin e automjeteve motorike

- 1.Për automjetet deri në 3.5 t.....10.00 €
- 2.Për automjetet mbi 3.5 t .....20.00 €
- 3.Obligues të taksës për automjete motorike janë personat fizik dhe juridik.
- 4.Regjistrimi bëhet në bazë të dëshmisë për pagesën e taksës përkatëse të lëshuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.
- 5.Nga pagesa e taksës komunale vjetore për regjistrimin e automjeteve motorike lirohen:
  - 5.1.Institucionet Komunale
  - 5.2.Organizatat humanitare
  - 5.3.Automjetet dhe makinat e zjarrfikësve dhe emergjencës

- 5.4. Invalidët e luftës dhe punës me shkallë të invaliditetit prej 20% e më shumë, personat me nevoja të veçanta, anëtarët e familjes së ngushtë të Dëshmorëve, të të zhdukurve dhe të viktimate civile të luftës (prindërit, bashkëshorti-ja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare).
6. Lirimet bëhen në bazë të dëshmisë me shkrim për statusin e njërsë prej kategorive të të cekura.
7. Në kuptim të nenit 11.5.4, brenda një viti, në kuadër të kategorive të cekura mund të regjistrohet vetëm një automjet pa pagesë të taksës përkatëse.

## Neni 12 Inspekcioni

### 1. Inspekcioni i tregut

1.1. Kërkesë për plotësimin e kushteve minimale teknike.....	10.00 €
1.2. Për lokale prej 0 deri 30 m <sup>2</sup> .....	30.00 €
1.3. Për lokale prej 30 deri 50 m <sup>2</sup> .....	60.00 €
1.4. Për lokale prej 51 deri 100 m <sup>2</sup> .....	100.00 €
1.5. Për lokale mbi 100 m <sup>2</sup> baza prej 100.00 euro plus për qdo m <sup>2</sup> nga.....	0.50. €
1.6. Kërkesë për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona fizikë.....	10.00 €
1.7. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona fizikë.....	8.00 €
1.8. Kërkesë për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona juridik.....	20.00 €
1.9. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona juridik.....	15.00 €
1.10. Kërkesë për asgjësim malli me afat të skaduar-prishur, ushqimore.....	20.00 €
1.11. Kërkesë për asgjësim malli me afat të skaduar-prishur, jo ushqimore.....	20.00 €
1.11.1. Malli në peshë prej 0 deri në 20 kg.....	10.00 €
1.11.2. Malli në peshë prej 20 deri në 50 kg.....	30.00 €
1.11.3. Malli në peshë prej 50 deri në 100 kg.....	50.00 €
1.11.4. malli në peshë prej 101 deri në 1000 kg.....	100.00 €
1.11.5. Malli në peshë prej 1001 deri në 10 000 kg.....	200.00 €
1.11.6. Malli në peshë mbi 10000 kg.....	300.00 €

### 2. Inspekcioni i Ndërtimitarisë

2.1. Kërkesa për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona fizikë.....	10.00 €
2.2. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona fizikë.....	8.00 €
2.3. Kërkesë për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona juridik.....	20.00 €
2.4. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona juridik.....	15.00 €

### 3. Inspekcioni i Komunalisë

3.1. Kërkesë për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona fizikë.....	10.00 €
3.2. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona fizikë.....	8.00 €
3.3. Kërkesë për kontrollë inspektimi jashtë qytetit për persona juridik.....	20.00 €
3.4. Kërkesë për kontrollë inspektimi në qytet për persona juridik.....	15.00 €
3.5. Kërkesë e PTK-së, KEDS-it për dalje në teren jashtë qytetit.....	100.00 €
3.6. Kërkesë PTK-së, KEDS-it për dalje në teren në qytet.....	50.00 €
3.7. Kërkesë e personave juridik për dalje në teren jashtë qytetit.....	100.00 €

3.8.Kérkesë e prsonave juridik pér dalje në teren në qytet.....	50.00 €
3.9.Kérkesë pér dalje në teren pér Kompanitë e Menagjimit të Mbeturinave dhe Kompanive tjera si motra.....	50.00 €

#### 4. Inspektioni Sanitar

4.1.Kérkesë pér kontrollë sanitare inspektimi jashtë qytetit pér personat fizik.....	10.00 €
4.2.Kérkesë pér kontrollë sanitare inspektimi në qytet pér personat fizik.....	8.00 €
4.3.Kérkesë pér kontrollë sanitare inspektimi jashtë qytetit pér persona juridik.....	20.00 €
4.4.Kérkesë pér kontrollë sanitare inspektimi në qytet pér persona juridik.....	15.00 €
4.5.Kérkesë pér asgjësim të mallit me afat të skaduar,prishur ushqimor.....	20.00 €
4.6.Pagesa pér mallin e prishur pér asgjasim sipas peshës:	
4.6.1.Malli në peshë prej 0 deri në 20 kg.....	10.00 €
4.6.2.Malli në peshë prej 21 deri në 50 kg.....	30.00 €
4.6.3.Malli në peshë prej 51 deri në 100 kg.....	50.00 €
4.6.4.Malli në peshë prej 101 deri në 1000 kg.....	100.00 €
4.6.5.Malli në peshë prej 1001 deri në 10000 kg.....	200.00 €
4.6.6.Malli në peshë mbi 10000 kg.....	300.00 €
4.7.Kérkesë pér dhënien e pëlqimit sanitar pér leje ndërtimi.....	10.00 €

#### 5. Inspektioni i Komunikacionit

5.1.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona fizik.....	10.00 €
5.2.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona fizik.....	8.00 €
5.3.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona juridik.....	20.00 €
5.4.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona juridik.....	15.00 €
5.5.Vendim pér plotësimin e kushteve pér operator(autobus).....	100.00 €
5.6.Vendim pér plotësimin e kushteve pér operator(radio-taxi).....	80.00 €
5.7.Vendim pér plotësimin e kushteve pér operator(minibus).....	50.00 €
5.8.Vendim pér plotësimin e kushteve pér operator(auto-taxi).....	15.00 €
5.9.Vendim pér plotësimin e kushteve pér operator(kombi 8+1).....	30.00 €
5.10.Vendim pér plotësimin e kushteve pér transport të mallrave(1-4 t).....	50.00 €
5.11.Vendim pér plotësimin e kushteve pér transport të mallrave(4-12 t).....	100.00 €

#### 6. Inspektioni i Bujqësisë

6.1.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona fizik.....	10.00 €
6.2.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona fizik.....	8.00 €
6.3.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona juridik.....	20.00 €
6.4.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona juridik.....	15.00 €
6.5.Kérkesë pér pëlqim i cili nevojitet pér licencimin e subjekteve afariste.....	20.00 €
6.6.Dhënya e procesverbalit ose pëlqimit pér plotësimin e kushteve pér licencim.....	100.00 €
6.7.Kérkesë pér asgjësim të mallit me afat të skaduar, prishur.....	20.00 €

#### 7. Inspektioni i Veterinës

7.1.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona fizik.....	10.00 €
7.2.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona fizik.....	8.00 €
7.3.Kérkesë pér kontrollë inspektimi jashtë qytetit pér persona juridik.....	20.00 €
7.4.Kérkesë pér kontrollë inspektimi në qytet pér persona juridik.....	15.00 €

7.5.Kontrollë inspektuese para therjes,pas therjes dhe vulosja e mishit nga ana e inspektorit të Veterinës për:

7.5.1.Kafshë të trasha.....	5.00 €
7.5.2.Kafshë të imta.....	2.00 €
7.5.3.Vërtetimin e lëshuar për kafshët e trasha nga veterinari i licencuar.....	5.00 €
7.5.4.Vërtetimin e lëshuar për kafshët e imta nga veterinari i licencuar.....	2.00 €
7.5.5.Vërtetimin për gjendjen e lëkurës së kafshëve për export-import.....	10.00 €
7.5.6.Vërtetim për mallin me prejardhje shtazore pëe export-import.....	10.00 €
7.5.7.Për leje udhëtimi për qenët dhe shpezët.....	5.00 €

### **Neni 13 Inspektimi dhe dhënia e pëlqimit ne lëmin e sigurisë dhe emergjencës**

